

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)**Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore**Facebook page : [Instituti i Gjeoshkencave](#), Webpage: www.geo.edu.al**Buletini Nr. 343/ 2022, 09-12-2022****Parashikimi** nga 09-12-2022, ora 12:00 deri më 10-12-2022, ora 23:59.**PARASHIKIM I RREZIKUT NGA PËRMBYTJET**

Gjatë fundit të ditës së sotme (e premte, dt.09) dhe gjatë ditës së nesërme (e shtunë, dt.10) do të ketë reshje me intensitet të lartë, të cilat do të jenë më të përqëndruara në veri dhe në jug të territorit. Në fund të ditës së nesërme reshjet intensive pritet të shtrihen në të gjithë territorin. Në qarqet Shkodër, Kukës, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjëve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave. Në zonat urbane, në këto qarqe mund të shfaqen probleme me përmbytje të lokalizuara, në varësi të gjendjes së kanalizimeve.

Ndërkohë, pritet një rritje e prurjeve të lumenjve kryesore, veçanërisht në lumenjtë Drin-Buna, Shkumbin dhe Vjosë.

Ky informacion do të përditësohet nga IGJEO sipas llogaritjeve më të fundit hidrologjike, dhe do të njoftoheni për çdo ndryshim në parashikimin e rrezikut të përmbytjeve.

PARASHIKIMI METEO**RESHJET**

Sot pasdite (e premte, dt.09) dhe nesër (e shtunë, dt.10) priten reshje intensive deri lokalisht shumë intensive në qarqet Shkodër, Kukës, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë, intensive në qarqet Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, ndërsa mesatare deri lokalisht intensive në qarqet e tjera (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

Në të gjitha qarqet reshjet priten të shoqërohen edhe me shtrëngata.

TEMPERATURAT

Nesër (e shtunë, dt.10) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:

në bregdet: 15 / 19 °C ; në vendet e ulëta: 13 / 18 °C ; në vendet malore: 9 / 14 °C

ERA

Sot pasdite (e premte, dt.09) dhe nesër (e shtunë, dt.10) era pritet të fryjë mesatare deri e fortë, sidomos në bregdet dhe në terrenet e larta malore.

NIVELET E RREZIKUT**S'KA RREZIK****I ULËT****I MODERUAR****I LARTË**

Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO

Operator: *Liljana Lata*Koordinator: *Alban Doko* (Tel: +355 69 311 9392, e-mail: albania.hazards@gmail.com)

faqe 1 / 3

BULETINI MBI RREZIQET NATYRORE (Bulletin on Natural Hazards)


















Qendra Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore

Facebook page : Instituti i Gjeoshkencave, Webpage: www.geo.edu.al

Buletini Nr. 343/ 2022, 09-12-2022

Parashikimi nga 09-12-2022, ora 12:00 deri më 10-12-2022, ora 23:59.

PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)

RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT	Zjarre në pyje	Ngjarje Meteorologjike			Ngjarje Hidrologjike		
	Zjarret Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut	Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara	Shtrëngata	Përmbytje të Shpejta	Përmbytje Lumenjsh	Rrëshqitje toke
SHKODËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
KUKËS	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
DIBËR	S'KA RREZIK	intensive					
LEZHË	S'KA RREZIK	intensive					
DURRËS	S'KA RREZIK	intensive					
TIRANË	S'KA RREZIK	intensive					
ELBASAN	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
FIER	S'KA RREZIK	mesatare					
BERAT	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
KORÇË	S'KA RREZIK	mesatare	intensive				
VLORË	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				
GJIROKASTËR	S'KA RREZIK	intensive	shumë intensive				





LEGJENDA: Reshjet 24-orëshe


Niveli i Rrezikut	Reshje shiu (mm / 24 orë)
S'KA RREZIK	të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë) Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I ULËT	mesatare (15 – 45 mm / 24 orë) Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike.
I MODERUAR	intensive (45 – 90 mm / 24 orë) Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike.
I LARTË	shumë intensive (> 90 mm / 24 orë) Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive.

LEGJENDA: Zjarre në pyje

S'KA RREZIK	Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht.
ULËT	Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë të mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara.
I MODERUAR	Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme.
I LARTË	Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë.

SIMBOLE

	Shtrengata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme
	Përmbytje urbane ose nga përrrenjtë dhe lumenjtë e vegjël
	Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj
	Rrëshqitje toke



**RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT
për sot dhe nesër, dt. 09 – 10.**